



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 10
26.06.2012

NR. VENDIMI 15
26.11.2012

VENDIM
“Ne emer te Republikes”

Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane
ne trup gjykues te perbere prej gjyqtareve:

Kryesuese : Iliriana OLLDASHI
Anetare : Flora HAJREDINAJ
Anetar : Bardhyl DHAMA

Asistuar nga sekretari gjyqesor **Besjan Hysi**, sot ne daten **26/11/2012**, ora **12.00 ne Tirane**, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore kerkesen **nr. 10 akti** qe i perket :

Kerkues: Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, **perfaqesuar ne gjykim nga prokurori G. T.**

Me objekt: **Konfiskimin e pasurive.**

KUNDER: Te paditurit

S. (S.) K., i biri i M.
dhe N., i datelindjes xx.xx.xxxx, banues ne
Tirane, Rruga « xxxx xxx », Pallati xx/xx.
(Aktualisht eshte duke vuajtur denimin prane
IEVP Vaqarr, Tirane).

Perfaqesuar ne gjykim nga perfaqesuesi me prokuren e posaçme date 22/12/2011 av. S. V. me nr. License profesionale 3716.

Personit te trete :

N. (N.) A., e bija e M.-it, dhe e B., e
datelindjes xx.xx.xxxx, banuese ne Tirane,
Rruga « xxxx xxxx », Pallati xx/xx. (Nena e
S. K.).

Perfaqesuar ne gjykim nga perfaqesuesi i zgjedhur me deklarim av. S.

V. me nr. License profesionale 3716.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 10192 date 03/12/2009 “Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimin te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese kunder Pasurise”.

Ne seancen e sotme gjyqesore te dates 26/11/2012 te zhvilluar ne prani te:

- prokurorit G. T. qe: Hoqi dore nga gjykimi i padise per konfiskimin e pasurive te te paditurit S. K. dhe personit te trete N. A. .

-perfaqesuesit te te paditurit S. K. dhe personit te trete N. A. qe kerkoi: Pushimin e gjykimit te konfiskimit per keto pasuri dhe heqjen e mases se sekuestros se vendosur ndaj tyre;

kjo gjykate pasi degjoi kerkimet dhe shqyrtoi aktet e paraqitura :

VEREN se :

Prokuroria per Krime te Renda Tirane ka paraqitur para kesaj gjykate nje kerkesepadi per konfiskimin e pasurise se te paditurit S. K. dhe personit te trete N. A. (nena e te paditurit) duke pretenduar se jane subjekte te hetimit pasuror sipas ligjit **nr.10192 date 03.12.2009** “Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimin te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese Kunder Pasurise” dhe nenit 333/a te Kodit Penal dhe pasurite e zoteruara nuk i pergjigjen nivelit te te ardhurave dhe fitimeve te tyre.

Kete kerkesepadi Prokuroria per Krime te Renda e ka paraqitur pas pranimit nga Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane me vendimin e saj **nr. 17, date 29/12/2011** te kerkeses per sekuestrimin e pasurise:

Llogarise bankare me nr. **XXXXXXXXXXXXXXXXXX**, e cila ndodhet prane Alpha Bank, si dhe *numri aktual XXXX XXXX XXXX XXXX XXX XXXX XXXX, ne shumen prej 15,129.67 (pesembedhjete mije e njeqind e njezet e nente pike gjashtedhjete e shtate) euro* ne emer te shtetases N. A. (nena e shtetasit S. K.), **e celur me date 04.06.2009.**

Keto veprime kane filluar pas rregjistrimit ne daten **17/06/2011**, ne Prokurorine per Krime te Renda te procedurave per hetim pasuror ndaj shtetasve **S. K. etj.**

Ky shtetas me vendimin penal **nr.31, date 27/05/2011** te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, eshte deklaruar fajtor per veprat penale te parashikuara nga nenet 333/a/2, 134/2, 139 (2 here) dhe 334 te Kodit

Penal dhe perfundimisht eshte denuar me vuajtjen e 11 (njembedhete) vjeteve burgim.

Me vendimin nr.49, date 13/09/2011 Gjykata e Apelit per Krime te Renda ka ndryshuar vendimin nr.31, date 27/05/2011 te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda nder te tjera edhe per prishjen dhe pushimin e ceshtjes penale ne ngarkim te te pandehurve S. K. etj., per vepren penale te parashikuar nga 333/a-1 i Kodit Penal.

Ne gjykimin e kesaj kerkesepadie, perfaqesuesi i personit te trete N. A. pretendoi se pasuria per te cilen kerkohet konfiskimi, pra llogaria bankare nuk eshte rrjedhoje e veprimtarise se kunderligjshme te djalit te saj S. K. , por jane te ardhura te cilat N. ja kane derguar nepermjet shoqerise se transfertave monetare Western Union, femijet e tjere te saj D. R. (K.), A. K. dhe V. K. me punen e tyre si emigrant ne France, Greqi dhe Belgjike. Ne mbeshtetje te ketij pretendimi perfaqesuesi i personit te trete paraqiti dhe faturat perkatese te Agjencise se Western Union ne Shqiperi qe pasqyrojne terheqjen e shumave te ndryshme monetare nga shtetasja N. A. .

Pas paraqitjes se ketyre provave ne seancen gjyqesore te dates **26/11/2012**,

prokurori G. T. , qe perfaqeson Prokurorine per Krime te Renda ne kete gjykim disponoi me heqjen dore nga gjykimi i kesaj padie me argumentin se provat e paraqitura provojne ligjshmerine e krijimit te pasurise objekt konfiskimi.

Perfaqesuesi i te paditurit S. K. dhe i personit te trete N. A. av. S. V. pas heqjes dore te prokurorit nga gjykimi i kesaj padie kerkoi pushimin e gjykimit.

Gjykata vlereson se pas heqjes dore te pales paditese nga gjykimi i kerkesepadise me objekt konfiskimin e llogarise bankare me nr. XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX, e cila ndodhet prane Alpha Bank ne emer te shtetases N. A. , ne baze te nenit 201/1 te Kodit te procedures civile duhet te vendose pushimin e ketij gjykimi.

Lidhur me masen e sekuestros se vendosur mbi kete pasuri ne emer te shtetases N. A. ne kushtet kur prokurori hoqi dore nga gjykimi per konfiskimin e saj pushojne dhe efektet e sekuestrimit te saj, ne kuptim te nenit **12/5** te ligjit **nr.10192 date 03.12.2009** “Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese Kunder Pasurise”.

Per kete arsye kjo gjykate vendos revokimin e mases se sekuestros se vendosur mbi kete pasuri me vendimin e saj **nr. 17, date 29/12/2011**.

Per ekzekutimin e ketij vendimi, ne perputhje me nenin 14 te ligjit **nr. 10192, date 03/12/2009** urdherohet Zyra e Permbarimit Gjyqesor Tirane dhe vihet ne dijeni administratori **z.G. L.**, i cili eshte caktuar per administrimin e kesaj pasurie, administrator prane Agjencise per Administrimin e pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane.

Mbi arsyetimin e pasqyruar me siper ne baze te nenit 201 e vijues te K.Pr.Civile dhe ligjit nr. 10192, date 03/12/2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese kunder Pasurise”, kjo gjykate pas kerkimit te paleve ndergjyqese :

VENDOSI

Pushimin e gjykimit te kerkesepadise me objekt konfiskimin e pasurise: llogari bankare me nr. XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX, e cila ndodhet prane Alpha Bank ne shumen prej 15,129.67 (pesembedhjete mije e njeqind e njezet e nente pike gjashtedhjete e shtate) euro, ne emer te shtetases N. A. (nena e shtetasit S. K. .

Revokimin e mases se sekuestros se vendosur me vendimin nr. 17, date 29/12/2011 te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane mbi kete pasuri.

Per ekzekutimin e ketij vendimi ngarkohet Zyra e Permbarimit Tirane.

Urdherohet sekretaria gjyqesore e kesaj gjykate te njoftoje per kete vendim administratorin **z.G. L.** i cili eshte caktuar per administrimin e kesaj pasurie, administrator prane Agjencise per Administrimin e pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim i veçante ne Gjykatën e Apelit per Krime te Renda brenda afatit ligjor.

U shpall sot ne Tirane, me date 26/11/2012, ora 12.30.

Sekretar

Besjan HYSI

Gjyqtare

Iliriana OLLDASHI

